

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POSTA E KOSOVËS SH.A**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a**

Nr i prokurimit	vetak-26-1925-2-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **“Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a”**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: DataProgNet SH.P.K.

Adresa : Rr. Qamil Ilazi, Nr. 16, 70000, Ferizaj

Numri Telefonit/ Numri i Faks-it: +38349789661

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj): Enver Shabani

Adresa elektronike: info@dataprognet-ks.com

Data e parashtrimit të ankesës: 18.07.2026

Nënshkrimi dhe vula:



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës) (Nënshkrim dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Sheno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë "apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

1. Njoftim për kontratë, publikuar në KRPP, më datë 10.04.2026
2. B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 17.04.2026
3. B12 Njoftim për Proces verbal të hapjes së Tenderëve më 25.06.2026
4. B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues më datë 02.07.2026
5. Kërkesë për qasje në dokumentacion nga DataProgNet SH.P.K. 03.07.2026
6. Njoftim për qasje në dokumentacion 03.07.2026, për datën 06.07.2026
7. Vendim nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim DataProgNet 10.07.2026
8. Dëshmia e pagesës për depozitë të sigurimit të ankesës në OSHP

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesin e hapjes së tenderit e kemi pranuar përmes platformës elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Nuk aplikohet

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RrPP). Në vijim po paraqesim rrethanat, faktet dhe argumentet për shkeljet e dispozitave të LPP-së dhe RrPP-së.

- Neni 1 - Qëllimi
- Neni 7 - Barazia në Trajtim / Mosdiskriminimi
- Neni 10 - Transparenca
- Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste
- Neni 68 - Informacionet Konfidenciale
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 108A - Kërkesa për Rishqyrtim

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

- Me datë 02.07.2026 nga Autoriteti Kontraktues (AK) përmes sistemit elektronik eProkurimi jemi njoftuar me Letër standarte për tenderuesit e eliminuar dhe për tenderuesin e suksesshëm.
- Me datë 03.07.2026 përmes sistemit eProkurimi kemi bërë kërkesë konform ligjit të KRPP-së dhe kemi kërkuar qasje zyrtare në ofertat e të gjithë Operatave Ekonomik (OE-ve) që kanë marrur pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe në ofertën e OE të propozuar si tenderues i suksesshëm.
- Me datë 06.07.2026, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga Autoriteti Kontraktues, në mënyrë jo transparente DataProgNet SH.P.K. nuk është lejuar të kemi qasje në pjesët e ofertave që nuk i takojn sekretit afarist bazuar në LPP, pjesë të ofertave që është bazuar vlerësimi teknik i ofertave bazuar në dosjen e tenderit si në vijim:
 - Propozimin Teknik,
 - Planin Dinamik,
 - Dokumentacionin e stafit të dedikua për projekt dhe
 - Dokumentacionin tjetër të ofertës që lidhet me përmbylljen e kërkesave teknike që kanë qenë pjesë e vlerësimit me pikë, pasi që kriteri për dhënie të kontraktit ka qenë "Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara në Aneksin 6 të dosjes së tenderit".

Me datë 06.07.2026, Autoriteti Kontraktues Posta e Kosovës sh.a. ka refuzuar kërkesën tonë për qasje në këto dokumente duke u mbështetur në nenet 68 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik, nene të cilat nuk e ndalojnë qasjen në pjesët e tenderit ku bëhet vlerësimi dhe krahasimi i ofertave me pikë.

Bazuar në LPP, Neni 11, Informatat Sekrete Afariste, tek pikat si në vijim:

3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

3.1 që ai ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

3.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikulit e tillë si sekret; dhe

3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 11 të LPP-së, duke mos na dhënë qasje në dokumentacionet e pjesëve së ofertës teknike që kanë qenë pjesë e vlerësimit me pikë dhe pa posedimin e këtyre pjesëve ne nuk kemi pasur mundësi si OE pjesëmarrës në këtë procedurë tenderike të krahasojmë ofertën tonë teknike me ofertën e OE-së të propozuar për kontrakt dhe të OE-ve tjerë pjesëmarrës.

Ne kemi mbetur të habitur se si në rezultatin e poentimit sipas nënkritereve të vlerësimit, nga 10 (dhjetë) operatorët ekonomikë të cilët janë vlerësuar si të përgjegjshëm, DataProgNet Sh.P.K. të renditet e fundit me pikë, ku DataProgNet Sh.P.K. është kompania që ka zhvilluar sistemin e automatizimit të sporteleve për Postën e Kosovës sh.a., me mbi 15 vite përvojë të dëshmuar dhe me referenca pozitive të lëshuara nga Posta e Kosovës sh.a., të renditet e fundit për nga pikët në këtë aktivitet të prokurimit, krahasuar me kompanit që asnjëherë nuk kanë punuar me shërbime postare dhe as me shërbime të pagesave.

Ashtu siç janë kërkuar në termat e e rrefecës në dosjen e tenderit, në ofertën tonë teknike kemi dorëzuar në mënyrë të detajuar secilën kërkesë të dosjes së tenderit, duke përfshirë:

- metodologjinë e punës;
- planin e implementimit;
- strukturën e ekipit të angazhuar;
- përvojën relevante në projekte të ngjashme;
- qasjen ndaj sigurisë, backup-it, rikuperimit dhe integriteteve me sisteme të tjera; dhe
- modelin e mbështetjes pas implementimit.

Megjithatë, në rezultatet e vlerësimit që kemi pranuar, nuk jemi njoftuar fare me pikët e fituara nga oferta jonë për secilin nënkriter, as me pikët e operatorëve të tjerë ekonomikë, konkretisht për:

- Metodologjinë e punës – të paraopara maksimum 20 pikë;
- Planin dhe afatin e implementimit – të paraopara maksimum 10 pikë;
- Qasjen ndaj sigurisë, backup-it, rikuperimit dhe integriteteve me sisteme të tjera – të paraopara maksimum 20 pikë;
- Modelin e mbështetjes pas implementimit – të paraopara maksimum 20 pikë; dhe
- Ofertën financiare – të paraopara maksimum 30 pikë.

Por me këto rezultate jemi njoftuar vetëm në përgjegjësinë e letër standarte pas kërkesës për rishqyrtim dhe nuk pajtohemi me këtë vlerësim, as me përgjegjësinë që kemi pranuar pas kërkesës për rishqyrtim dhe për këtë arsye e paraqesim këtë ankesë pranë OSHP-së me këto pankanqësi dhe pretendime:

1. **Pretendimi 1 i ankesës:** AK ka shkelur Neni 1 – Qëllimi, të LPP-së, sespe AK Posta e Kosovës nuk ka siguruar në mënyrë efikase dhe transparente shfrytëzimin e fondeve publike, pasi që posedon në shfrytëzim sistemin e njetë dhe ka kontratë edhe 6 muaj me ne si OE për mirëmbajtje dhe avancime dhe jemi të bindur se nuk ka nevojë Posta e Kosovës si kompani publike të shpenzoj mjete për zhvillimin dhe implementimi e një sistemi të ri qendror të Postës së Kosovës sh.a. që do të jetë i njëjti me sistemin aktual. Në këtë rast shfrytëzimi i fondeve publike po tetrohet të bëhet me pa të drejtë duke shpenzuar mjete për një produkt që ka në shfrytëzim Posta e Kosovës.

2. **Pretendimi 2 i ankesës:** AK ka shkelur Neni 7 dhe Nenin 59, të LPP-së, sespe AK Posta e Kosovës nuk na ka udhëzuar as trajtuar si palë e barbartë në këtë procedurë prokurimi duke na diskriminuar me mos dhënie të qasjes në pjesët e ofertave që nuk i ndalon ligji i KRPP-së dhe ne si OE ende e kemi të pa qartë se me çfarë oferta teknike, plan dinamik të implementimit dhe staf kanë ofertuar OE-të pjesmarrëse në këtë procedurë prokurimi, për ne janë të njohura vetëm ofertat finaciare, ku pesha e ofertës finaciare ka qenë e peshuar me 30 pikë nga 100 të mundëshme dhe nuk kemi mundur ta gjejmë në LPP se a lejohet ndonjë peshim i pikëve: ofertat finaciare (çmimi) 30%, ndërsa oferta teknike 70%.

3. **Pretendimi 3 i ankesës:** AK ka shkelur Neni 10, Neni 11 dhe Nenin 68, të LPP-së, sespe AK Posta e Kosovës pas kërkesës me shkrim nuk na ka dhënë qasje në ofertat finaciare duke i konsideruar sekret afaristë edhe pjesët e ofertave që nuk janë sekret afarist. Mungesa e transparencës në paraqitjen e pikëve sipas secilit nënkriter e bën të pamundur verifikimin e drejtësisë së vlerësimit dhe bie ndesh me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe llogaridhënies të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsytim konkret lidhur me secilin dokument individual dhe nuk ka sqaruar se për cilën arsye secili prej tyre konsiderohet sekret afarist. Vetë fakti që Operatori Ekonomik i propozuar si tenderues i suksesshëm i ka klasifikuar dokumentet si konfidenciale nuk e përjashton detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të vlerësuar nëse klasifikimi është bërë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe për të mundësuar qasje në ato pjesë të dokumentacionit që nuk përbëjnë sekret afarist ose në versione të ndryshuara (përditsuara). Mosdhënia e këtyre dokumenteve e pamundëson ushtrimin efektiv të së drejtës për rishqyrtim, pasi DataProgNet SH.P.K. nuk ka mundësi të verifikojë nëse Operatori Ekonomik i rekomanduar ka përmbyshur kërkesat teknike dhe administrative në Dosjes së Tenderit dhe nëse Komisioni Vlerësues ka zbatuar kriteret e vlerësimit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Për këtë arsye, Propozimi Teknik, Plani Dinamik i Implementimit dhe dokumentacioni i stafit kyç përbëjnë dokumentacionin më të rëndësishëm për të vlerësuar nëse zgjidhja e propozuar nga operatori ekonomik i rekomanduar është realisht e realizueshme dhe në përputhje me kompleksitetin teknik, funksional dhe operacional të sistemit ekzistues.

4. **Pretendimi 4 i ankesës:** Nuk pajtohem me AK Posta e Kosovës në sqarimet që ka dhënë në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, se iniciimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bazuar në nevojën institucionale për modernizim të sistemit qendror, ngritje të sigurisë, përmirësim të mirëmbajtshmërisë, përdorim të teknologjive aktuale të kohës dhe të mbështetura, si dhe përshtatje me kërkesat e reja funksionale, operative dhe integruese të Postës së Kosovës sh.a., ku edhe thotë se: Sistemi ekzistues, pavarësisht shërbimit të tij ndër vite, ka kufizime teknike dhe arkitekturore që lidhen me vjetërsimin e teknologjisë, ciklin e mbështetjes së komponentëve teknologjikë dhe kërkesat bashkëkohore të sigurisë dhe integritetit. Për këtë arsye, AK ka pasur të drejtë dhe nevojë objektive të zhvillojë procedurë konkurruese për sistem të ri/modernizuar qendror. Ne si OE shprehim shqetësimin tonë se, në vend që të investohet në avancimin dhe modernizimin e sistemit ekzistues, i cili është ndërtuar dhe përmirësuar ndër vite, është zgjedhur qasja për ndërtimin e një sistemi të ri nga fillimi. Ky vendim, sipas vlerësimit tonë profesional, paraqet rrezik të konsiderueshëm për vazhdimësinë e shërbimeve dhe për investimin shumëvjeçar të bërë nga Posta e Kosovës, ku vlera e mirëmbajtjes mujore siç është e njohur për AK Posta e Kosovës është simbolike, por ne si OE vazhdimisht i kemi kuptuar me sqarime që na keni dhënë se nuk po qëndroni mirë financiarisht si Postë e Kosovës dhe kemi krijuar nënsisteme të shumta brenda sistemit SASP pa pagesa shtesë dhe kemi dhënë shërbime edhe për këto nënsisteme dhe module me vite e dekata vetëm e vetëm që një ditë Postën Publike të vendit dhe shtetit tonë ta shohim të krahasueshme me postat publike ndërkombëtare. Si kompani profesionale e zhvillimit të softuerit brenda dhe jashtë vendit, kostatojmë me kompetencë se Sistemi qendror që ka aktualisht në përdorim Posta e Kosovës të quajtur SASP është modern, i shtrirë në të gjitha pikat e Postës në Kosovë, komunikon pa probleme përmes Ueb API-ve me sisteme brenda dhe jashtë vendit në kohë reale, nuk ka kufizime teknike, është i sigurt, ka përmirësim të mirëmbajtshmërisë ndërvite, është avacuar në teknologji aktuale të kohës dhe të mbështetura, si dhe adaptohet dhe përshtatet me kërkesat e reja funksionale, operative dhe integruese të Postës së Kosovës sh.a., ku për të gjitha këto shërbime dhe avacime janë në dijeni zyrtarë e Postës së Kosovës që përdorin në baza ditore SASP-in.

5. **Pretendimi 5 i ankesës:** Pas analizës së dosjes së tenderit kemi konstatuar se pothuajse të gjitha kërkesat funksionale të kërkuara në këtë procedurë tashmë janë të imlementuar nga sistemi aktual SASP. Për më tepër, sistemi ekzistues përmban mbi 70% më shumë module, nën-sisteme dhe funksionalitete sesa ato të kërkuara në dokumentacionin e tenderit. Kjo tregon se nevoja reale nuk është zëvendësimi i sistemit, por zhvillimi dhe avancimi i tij në përputhje me kërkesat e reja të biznesit. Vlersuar nga vet Posta sh.a. SASP-i aktual është një sistem modern, i krahasueshëm me sistemet e implementuara në administratat postare të vendeve evropiane dhe më gjerë, dhe përfaqëson një investim të rëndësishëm institucional. Për këtë arsye, konsiderojmë se RIVLERËSIMI, e nëse është e nevojshme edhe ANULIMI i kësaj procedure të prokurimit, është në interes të drejtpërdrejtë të Postës së Kosovës sh.a. dhe të mbrojtjes së interesit publik dhe fondeve publike.
6. **Pretendimi 6 i ankesës:** Nga analiza e vendimit lidhur me përgjigjet në kërkesën për rishqyrtim të datës 10.07.2026, rezulton se Autoriteti Kontraktues Posta e Kosovës Sh.A), për herë të parë, ka dhënë arsytetime lidhur me zbritjen e pikëve në nënkriteret e vlerësimit teknik. Megjithatë, këto arsytetime nuk burojnë nga kërkesat obligative të Dosjes së Tenderit, por nga elemente shtesë të cilat nuk janë kërkuar asnjëherë nga Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së tenderimit. DataProgNet SH.P.K. gjatë përgatitjes së ofertës ka respektuar me përpikëri Dosjen e Tenderit dhe Specifikimet Teknike, duke dhënë përgjigje të plota për secilën kërkesë të detyrueshme të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues. Çdo kërkesë obligative është trajtuar, argumentuar dhe dokumentuar në ofertën tonë teknike. Megjithatë, në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues pretendon se oferta jonë nuk është vlerësuar maksimalisht sepse, sipas tij, nuk përmban elemente si mekanizma shtesë kontrolli, nivel më të madh detajimi, parametra shtesë për backup dhe rikuperim, fleksibilitet më të avancuar të integriteteve dhe përshkrime të tjera të ngjashme. Këto nuk kanë qenë kërkesa obligative të Dosjes së Tenderit, nuk kanë qenë pjesë e kriterëve të publikuara dhe nuk janë kërkuar në asnjë pikë të dokumentacionit të tenderit.
7. **Pretendimi 7 i ankesës:** Nëse Posta e Kosovës sh.a. nuk ka pasur në plan të vazhdojë përdorimin dhe zhvillimin e sistemit SASP, do të ishte e arsyeshme dhe në përputhje me parimet e bashkëpunimit kontraktual që fillimisht të njoftohej DataProgNet SH.P.K. pasi Posta është duke shfrytëzuar sistemin që është në pronësi të kompanisë sonë, duke pasur parasysh se ndërmjet palëve ekziston një kontratë valide dhe në fuqi, për të cilën Autoriteti Kontraktues është në detyrë.

Duke pasur parasysh përvojën tonë të dëshmuar, cilësinë e ofertës së dorëzuar dhe mungesën e një arsytimi të detajuar të poentimit, kërkojmë nga OSHP që ta rishqyrtoni me kujdes këtë proces të vlerësimit dhe ta ktheni projektin në RIVLERËSIM nga një komision që garanton vlerësim objektiv duke ofruar një arsyetim të plotë dhe transparent të pikëve të dhëna për secilin nënkriter, në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik apo bazuar më faktete eparaqitura në pretendimet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të ANULOHEJ kjo procedurë tenderike, pasi që, në kontaktim me procedurë të hapur tenderike DataProgNet SH.P.K. është kompania që prej shumë vitesh ka zhvilluar, implementuar dhe mirëmbajtur Sistemin e Automatizimit të Sporteleve të Postës (SASP), i cili përbën sistemin qendror të operimit të Postës së Kosovës Sh.A. dhe është pikërisht objekti i këtij aktiviteti të prokurimit.

Bazuar në përvojën tonë shumëvjeçare si zhvillues dhe mirëmbajtës i këtij sistemi, jemi të befasuar se si është konsideruar e realizueshme një ofertë që pretendon ndërtimin nga fillimi të një sistemi të ri qendror për Postën e Kosovës sh.a. brenda afateve të implementimit të propozuara. Një plan i tillë, sipas vlerësimit tonë profesional dhe përvojës sonë praktike, nuk është realisht i zbatueshëm për ndonjë OE që nuk ka referca për sisteme të njehta. Ku Posta e Kosovës sh.a. e din mirë dhe ka fakte sa kushton një sistem i tillë dhe sa duhet kohë për një OE të ri të i kuptoj këto procese.

Vetëm faza e analizimit të proceseve të biznesit, studimit të legjislacionit, analizës së kërkesave funksionale dhe teknike, si dhe kuptimit të proceseve operative të Postës së Kosovës, ka kërkuar 3 vite pune dhe zhvillim të vazhdueshëm për të u kuptuar nga ne si OE shumë i përkushtuar. Këto procese nuk mund të zëvendësohen apo të realizohen brenda pak javësh ose muajsh pa krijuar rreziqe serioze për funksionimin e sistemit.

Bazuar në analizën tonë teknike dhe përvojën shumëvjeçare në këtë projekt, konsiderojmë se humbësi më i madh i kësaj procedure, nëse vazhdon në këtë formë, nuk do të jetë DataProgNet SH.P.K., por vetë Posta e Kosovës sh.a. dhe

Republika e Kosovës, e cila rrezikon të humbasë një sistem të konsoliduar, të dëshmuar dhe të zhvilluar ndër vite, duke u ekspozuar ndaj rreziqeve të panevojshme teknike, operacionale dhe financiare.

Nga raporti i vlerësimit rrjedh se Operatori Ekonomik i rekomanduar është vlerësuar me pikët maksimale për kriteret teknike, ndërsa DataProgNet SH.P.K. është vlerësuar me pikë dukshëm më të ulëta. Për shkak të mungesës së qasjes në dokumentacionin teknik, DataProgNet SH.P.K. nuk ka mundësi të verifikojë nëse ky vlerësim është bërë në përputhje me dosjen e tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke krijuar dyshime të arsyeshme mbi ligjshmërinë dhe objektivitetin e procesit të vlerësimit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se transparencja e plotë e procesit të vlerësimit teknik dhe qasja në arsyetimin e detajuar për secilin kriter janë të domosdoshme për të mundësuar verifikimin e ligjshmërisë, barazisë në trajtim dhe zbatimit korrekt të kriterëve të vlerësimit.

DataProgNet SH.P.K. konsideron se vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar në ligj dhe në fakte, pasi nuk i trajton në mënyrë objektive pretendimet tona, por tenton të justifikojë vendimin e marrë paraprakisht përmes arsyetimesh që nuk mbështeten në dokumentacionin e procedurës së prokurimit.

Prandaj lind pyetja thelbësore: Si mund të penalizohet një operator ekonomik për mosplotësimin e kërkesave që Autoriteti Kontraktues nuk i ka kërkuar asnjëherë?

Nëse Komisioni Vlerësues ka konsideruar se këto elemente kanë qenë të rëndësishme për vlerësimin, atëherë ato është dashur të përfshiheshin qartë në Dosjen e Tenderit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kishin mundësi të barabartë t'i adresonin në ofertat e tyre.

Vlerësimi i ofertave nuk mund të bazohet në kritere të padeklaruara, në pritshmëri subjektive apo në standarde që nuk janë bërë publike paraprakisht. Një qasje e tillë cenon drejtpërdrejt parimin e transparencës, trajtimin të barabartë dhe sigurinë juridike, pasi operatorët ekonomikë kanë të drejtë të dinë paraprakisht se mbi çfarë kriteresh do të vlerësohen.

Po aq shqetësues është fakti se këto arsyetime nuk janë paraqitur në raportin fillestar të vlerësimit, por vetëm pasi është dërguar kërkesa për rishqyrtim e që rrjedhimisht krijon përshtypjen se arsyetimi është ndërtuar "ex post facto", me qëllim justifikimin e rezultatit të arritur, dhe jo si pjesë e procesit të rregullt të vlerësimit e që rrjedhimisht ligjshmëria e një vendimi nuk mund të mbështetet në arsyetime të krijuara pas marrjes së tij. Autoriteti Kontraktues vazhdon të refuzojë qasjen në pjesët kryesore të ofertës teknike të operatorit ekonomik të rekomanduar, duke e pamundësuar verifikimin nëse të njëjtat standarde janë zbatuar për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë tenderike. Në mungesë të kësaj transparence, nuk ekziston asnjë mundësi reale për të kontrolluar nëse vlerësimi është bërë në mënyrë të barabartë apo nëse kriteret janë zbatuar në mënyrë selektive.

DataProgNet SH.P.K. nuk kërkon trajtim preferencial, por kërkon që oferta jonë të vlerësohet mbi bazën e kriterëve që vetë Autoriteti Kontraktues ka publikuar dhe jo mbi bazën e kriterëve të reja, të paformalizuara dhe të panjohura për operatorët ekonomikë në momentin e përgatitjes së ofertës.

Në një procedurë të prokurimit publik, nuk është përgjegjësi e operatorëve ekonomikë të hamendësojnë pritshmëri që nuk janë të shkruara në Dosjen e Tenderit konkretisht në specifikat teknike obligative.

Përgjegjësia e operatorëve ekonomik është që të përmbushin kërkesat e publikuara obligative në dosjen e tenderit.

Kur një operator ekonomik penalizohet për mosplotësimin e kërkesave që nuk kanë ekzistuar në dokumentacionin e tenderit, atëherë nuk kemi më një proces transparent dhe konkurrues, por një vlerësim të bazuar në kritere të panjohura, gjë që bie ndesh me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik. Për këto arsye, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është i pabazuar, jo mjaftueshëm i arsyetuar dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe ligjshmërisë.

Për këtë arsye kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta pranojë ankesën si të bazuar, të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ta kthejë procedurën në RIVLERËSIM apo ANULIM, duke garantuar një vlerësim objektiv, transparent dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e lartpërmendura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) të marrë për bazë ankesën e OE DataProgNet SH.P.K. që të **ANULOJ** vendimin e datë 02.07.2026 dhe ta kthejë këtë lëndë në **RIVLERSIM** ose **ANULIM**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmi material i përgatitjes së ofertës si dhe dëmet tjera do të pasqyrohen pas një analize të detajuar profesionale.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

1. Njoftim për kontratë, publikuar në KRPP, më datë 10.04.2026
2. B54 Formulari standard për korrëgjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 17.04.2026
3. B12 Njoftim për Proces verbal i hapjes së Tenderëve më 25.06.2026
4. B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues më datë 02.07.2026
5. Kërkesë për qasje në dokumentacion nga DataProgNet SH.P.K. 03.07.2026
6. Njoftim për qasje në dokumentacion 03.07.2026, për datën 06.07.2026
7. Vendim nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim DataProgNet 10.07.2026
8. Dëshmia e pagesës për depozitë të sigurimit të ankesës në OSHP

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ PUNË

☐ FURNIZIM

☒ SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: **10.04.2026**

Nr i Prokurimit	vetak-26-1925-2-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: POSTA E KOSOVËS SH.A		
Adresa Postare: DARDANIA		
Qyteti: PRISHTINË	Kodi postar: -	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Fllanza Shabi Bujar Sopi		Telefoni: +383 555211
Email: prokurimi@postakosoves.com		Faksi: ///
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): http://postakosoves.com		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referojnë një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a		
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit <i>(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)</i>		
☐ Punë	☐ Furnizime	☒ Shërbime
☐ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	
Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit Në Postën e Kosovës		
II.1.3) Njoftimi përfshinë Krijimin e kontratës publike kornizë ☐		
II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet): Kontrate publike kornizë me një operator ☐ Kontrate publike kornizë me disa operator ☐ Ekzekutimi i kontratës: Thirrje/Porosi ☐ Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë ☐ Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj		
II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi qendror, të integruar dhe të standardizuar, i cili do të mbështesë transformimin digjital të proceseve kryesore të Postës së Kosovës në kuadër të veprimtarisë postare dhe financiare jo bankare (IFJB). Zgjidhja synon rritjen e efikasitetit operacional, zvogëlimin e ndërhyrjeve manuale, përmirësimin e saktësisë së të dhënave, si dhe sigurimin e transparencës dhe përmirësimin e shërbimeve.		

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**93000000-8****II.1.7) Variantet pranohen**Po ☐ Jo ☒**II.1.8) Ndarja në Pjesë**Po ☐ Jo ☒*Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)*☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)**

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 170,000.00****II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS****Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës.****II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM****Kohëzgjatja në muaj 6 apo ditë (nga dhënia e kontratës)**
apo
Fillimi
Përfundimi**NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE****III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN****III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**Po ☒ Jo ☐*Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit* EUR ose **10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 13 muajsh** % e vlerës së kontratës**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):****III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Operatori Ekonomik duhet të përmbush kërkesat e specifikuara në nenin 65 të ligjit të prokurimit publik nr. 04 L-042, i ndryshuar dhe i plotsuar me Ligjin Nr. 04 L-237, Ligjin Nr. 05 L-068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092. a) Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmerin.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: a) Deklarata nën betim, e cila gjindet në dosje të tenderit ANEKSI 2 të jetë e vulosur dhe e nënshkruar
b) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik , se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tre mujorin e fundit para dorëzimit të tenderit	b) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, dokumenti duhet të jetë origjinal me bar cod Ky dokument është obligativë të dorëzohet nga tenderuesi i cili do të shperblehet me kontratë, dokumenti dorëzohet pranë AKsëpara njoftimit mbi vendimin e AK-së. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi (oferta) në fjalë do të refuzohet.
c) Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike. Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që përmbush “kërkesat e përshtatshmërisë” Të mos jetë më i vjetër se tre muaj nga dorëzimi i tenderit.	c) Vërtetimin e gjykatës ekonomike dokumenti duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar. Ky dokument është obligativë të dorëzohet nga tenderuesi i cili do të shperblehet me kontratë, dokumenti dorëzohet pranë AK-së para njoftimit mbi vendimin e AK-së. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi (oferta) në fjalë do të refuzohet
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Certifikata e Regjistrimit të biznesit, se bashku me përshkrimin e veprimtarisë primare dhe sekondare Certifikata e Regjistrimit për TVSH	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kopja e Certifikatës se Regjistrimit të biznesit, se bashku me përshkrimin e veprimtarisë primare dhe sekondare Kopja e Certifikatës se Regjistrimit për TVSH
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: N A	Dëshmia e kërkuar dokumentare: N A
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1) Operatori ekonomik(ose Grupi) gjatë tri viteve të shkuara (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) duhet të ketë të realizuar-përfunduar se paku një apo disa kontrata (shërbime) të njejta apo te ngjajshme.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Një liste qe specifikon shërbimet e kryera nga ana e operatorit ekonomik (ose Grupit), shumën e kontratës, datën dhe pranuesin -it. Listës duhet ti bashkëngjitet kopje dëshmitë përkatëse; (i) kur furnizimet janë bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtyre shërbimeve shërben kopja e kontratës dhe referenca apo raporte të pranimit të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë.. (ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për

	dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i ekzekutimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka.
OE duhet të posedojë së paku stafin kyç si në vijim Një projekt menaxher	Për projekt menaxher si dëshmi duhet të paraqitet kopja e dokumentit të identifikimit, CV, kopje e kontratës së punës apo marreveshje për projektin në fjalë.
Një Frontend Developer	Për Frontend Developer si dëshmi duhet të paraqitet kopja e dokumentit të identifikimit, CV, kopje e kontratës së punës apo marreveshje për projektin në fjalë.
Një Backend Developer	Për Backend Developer si dëshmi duhet të paraqitet kopja e dokumentit të identifikimit, CV, kopje e kontratës së punës apo marreveshje për projektin në fjalë.
Deklaratë mbi specifikimet teknike.	Deklarata e nënshkruar dhe vulosur mbi përmbushjen e kërkesave të specifikimit teknik

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☒

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po ☐ Jo ☒

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

☒ E hapur

☐ E kufizuar

☐ Konkurruese me negociata

☐ Kuotim i Çmimit

IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)

Në bazë të aplikacioneve të pranura, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të riekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociata)

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ Jo ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po ☐ Jo ☐

**IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë
Tenderët fillestar është:**

IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik

Do të përdoret ankand elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese në lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☐ Çmimi më i ulët

ose

☒ Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Nënkriteret		Koeficient
1	Çmimi 30 % (30 pikë)	
2	Metodologjia e punës 20% (20 pikë)	
3	Plani dhe afati i implementimit 10 % (10 pikë)	
4	Qasja ndaj sigurisë, backup-it dhe integriteteve 20 % (20 pikë)	
5	Mbështetja pas implementimit 20 % (20 pikë)	

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☐ Jo ☒

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (nëse aplikohen):

i

i

Po ☐ Jo ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:

data 25.05.2026 koha 14:00:00 vendi Dorzimi i tenderëve (ofertave) bëhet vetëm nëpërmjet platformës elektronike,

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:

☐ Po ☒ Jo

Nëse po, jep arsyetim

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit 5000€ ne kohezgjatje prej 120 diteve

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët 90 apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 25.05.2026 koha 14:00:00 vendi Ndërtesa Qendrore e Postës së Kosovës sh.a , Prishtinë- Rr. 28 Nëntori nr 4. Zyra e Prokurimit

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)

Tek kriteret e përzgjedhjes më hollësisht ju lutem ju referoheni Aneksit 6 të dosjes së tenderit.

NJOFTIM PER INFORMATA SHITESE ose PERMIRESIM I GABIMIT

Sipas Nenit 53 të Ligjit Nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

☐ Punë☐ Furnizim☒ Shërbime

[Përkujtese: Nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtese shpije ne një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin original të kontratës me një influencë mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe në objektivin e prokurimit konkurrues, do të jetë e nevojshme zgjatja e afateve fillimisht të parapara]

Data e përgatitjes të këtij njoftimi: 10.04.2026

Nr i Prokurimit	vetak-26-1925-2-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: POSTA E KOSOVËS SH.A		
Adresa Postare: DARDANIA		
Qyteti: PRISHTINË	Kodi postar: -	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Fllanza Shabi Bujar Sopi		Telefoni: +383 555211
Email: prokurimi@postakosoves.com		Faksi: ///
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		http://postakosoves.com

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: (ashtu siç është përcaktuar në njoftimin origjinal të kontratës)
Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a

II.1.2) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi qendror, të integruar dhe të standardizuar, i cili do të mbështesë transformimin digjital të proceseve kryesore të Postës së Kosovës në kuadër të veprimtarisë postare dhe financiare jo bankare (IFJB). Zgjidhja synon rritjen e efikasitetit operacional, zvogëlimin e ndërhyrjeve manuale, përmirësimin e saktësisë së të dhënave, si dhe sigurimin e transparencës dhe përmirësimin e shërbimeve.

II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

93000000-8

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

III.1.1) Lloji i procedurës (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

☒ E hapur
☐ E kufizuar
☐ Konkurruese me negociata
☐ Kuotim i çmimit

III.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.2.1) Data e publikimit të njoftimit origjinal të kontratës:

NENI IV: INFORMACIONET PLOTËSUESE

IV.1) KY NJOFTIM PËRFSHINE		
Përmirësim ☒	Informata shtesë ☐	
Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Njësia e Prokurimit-Posta e Kosovës sh.a.



B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ¹²

Data: 02.07.2026

Nga: Posta e Kosovës SH.A - Ndërtesa Qendrore e Postës së Kosovës sh.a , - Rr. 28 Nëntori nr 4.

Për: Operatorin Ekonomik: **SIMS SH.P.K.- Prishtinë**

Nr. i Prokurimit:	Vetak	26	1925	2-1-1
Nr i brendshem	PK	26	26	211

Titulli: **Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a**

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM:

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Gjatë vlerësimit të ofertës tuaj komisioni i vlerësimit ka konstatuar se ju si Operator Ekonomik nuk i përmbushni kërkesat e përcaktuara tek "*Kapaciteti teknik dhe profesional*" të cilat janë vendosur ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë ku është kërkuar:

Kërkesa:

Deklaratë mbi specifikimet teknike.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deklarata e nënshkruar dhe vulosur mbi përmbushjen e kërkesave të specifikimit teknik.

Ju me dorëzimin e ofertës **NUK** e keni bashkangjitur deklaratën mbi specifikimet teknike sipas kriterit të lartëcekur

¹² Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

Po ashtu me dorëzimin e ofertes NUK e keni bashkangjitur sigurinë e tenderit, andaj bazuar në nenin 57.2 të LPP-së si dhe nenin 10 të UDHËZUESIT Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK thuhet: (Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm)

Bazuar në konstatimet e lartcekura komisioni i vlerësimit ju konsideron si të papërgjegjshëm.
Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Njësia e Prokurimit-Posta e Kosovës sh.a.



B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ¹³

Data: 02.07.2026

Nga: Posta e Kosovës SH.A - Ndërtesa Qendrore e Postës së Kosovës sh.a , - Rr. 28 Nëntori nr 4.

Për: Operatorin Ekonomik: **CMD SH.P.K.,-Prishtinë**

Nr. i Prokurimit:	Vetak	26	1925	2-1-1
Nr i brendshem	PK	26	26	211

Titulli: **Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a**

!/:e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM:

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Gjatë vlerësimit të ofertës tuaj komisioni i vlerësimit ka konstatuar se ju si Operatorë Ekonomik nuk i përmbushni kërkesat e përcaktuara tek "*Kapaciteti teknik dhe profesional*" të cilat janë vendosur ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë ku është kërkuar:

Kërkesa:

Deklaratë mbi specifikimet teknike.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deklarata e nënshkruar dhe vulosur mbi përmbushjen e kërkesave të specifikimit teknik.

Ju me dorëzimin e ofertës NUK e keni bashkangjitur deklaratën mbi specifikimet teknike sipas kriterit të lartëcekur

Bazuar ne konstatimet e lartcekura komisioni i vlerësimit ju konsideron si të papërgjegjshëm.

¹³ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Njësia e Prokurimit-Posta e Kosovës sh.a.

KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTACION

Nga: **DataProgNet SH.P.K.**

Për: **POSTA E KOSOVËS SH.A**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **vetak-26-1925-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **'Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a'**

Konform Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullave të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), kërkojmë qasje zyrtare në dokumentacionin e procedurës së prokurimit, përfshirë ofertat e të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si dhe raportin e vlerësimit të ofertave, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Enver Shabani
Drejtor i përgjithshëm



Datë: 03.07.2026



Konform kërkeses NGA: Operatori Ekonomik **"Data Prognnet Shpk."**

Lidhur me : aktivitetin e prokurimit me titull **"Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a"** me nr. të prokurimit vetak-26-1925-2-1-1 dhe numer te brendshem:PK-26-26-211 per qasje ne dokumente zyrtare ne dokumentet :

-Të gjitha ofertat e të gjithë operatoreve ekonomik pjesemarres,si dhe raportin e vleresimit te ofertave ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

OE:"Data Prognnet Shpk." ju ofrojme qasjen te hënen me dt 06.07.2026 prej ores 10:30h

Njesia e prokurimit-Posta e Kosovës



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Posta Kosovo D.O.

Nr./No./Br. 01-1294/26
Data/Date/Datum 10-07-2026
PRISTINE-PRISTINA-PRISTINA

Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.

DATE:	10.07.2026
PËR:	Operatorin Ekonomik: "DataProgNet:Shpk Rr Qamil Ilazi Nr 16-Ferizaj
KOPJE:	znj. Nora Rraci, Kryeshef Ekzekutiv / Posta e Kosovës SH.A.
NGA:	Fllanza Shabi, U.D Menaxhere e Prokurimit / Posta e Kosovës SH.A.
TEMA:	Vendim lidhur me kërkesen për rishqyrtim të dorzuar nga OE: "DataProgNet:SHPK Prishtine me datë 07.07.2026



Duke u bazuar në paragrafin 10.1 të nenit 108/A të Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Autoriteti Kontraktues Posta e Kosoves sh.a, nxjerr:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e dorëzuar nga OE: "DataProgNet"SHPK - Prishtine me datë 07.07.2026, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues Posta e Kosovës sh.a. për aktivitetin e prokurimit: **"Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a"** me numër të prokurimit: **vetak-26-1925-2-1-1 dhe numër të brendshem:PK-26-26-211**

Mbetet në fuqi – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues Posta e Kosovës sh.a.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues Posta e Kosoves, gjegjesisht Njesia e Prokurimit pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim të datës 07.07.2026 për aktivitetin e prokurimit : **"Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a"** me numër të prokurimit: **vetak-26-1925-2-1-1 dhe numër të brendshem:PK-26-26-211**, fillimisht me date 06.07.2026, ka nxierr vendim me të cilin është pezulluar aktiviteti i prokurimit pas kerkese per rishqyrtim te nje Operatori tjeter Ekonomik.

Pas pezullimit të aktivitetit AK Posta e Kosovës sh.a, ka shqyrtuar Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga OE ankues **"DataProgNet"SHPK**, Prishtine, lidhur me Njoftimin mbi vendimin e A.K. Posta e Kosovës sh.a. dhe ka konstatuar se:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë se, AK ka shkelur:

Neni 1-Qëllimi

Neni 7 - Barazia ne Trajtim/Mosdiskriminim

Neni 10 - Transparenca

Neni 11- Informatat Sekrete Afariste

Neni 68 - Informacionet Konfidenciale

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

duke nderlidhur pretendimet e lartëcekura me arsyetimet e cekura në deklaratën e kërkesës për rishqyrtim si vijon:

PRETENDIMET E OPERATORIT EKONOMIK

Me datë 02.07.2026 nga Autoriteti kontraktues (AK) përmes Sistemit elektronik e Prokurimi jemi njoftuar me Letrat standarte për tenderuesit e eliminuar dhe për tenderuesin e sukseshëm,

Me datë 03.07.2026 përmes sistemit eProkurimi kemi bere kerkesë konform ligjit të KRPP-së dhe kemi kërkuar qasje zyrtare ne ofertat e te gjithë Operatave Ekonomik (OE-ve) qe kanë marrë pjese ne këtë aktivitet të prokurimit dhe ne ofertën e OE te propozuar si tenderues i suksesshëm.

Me datë 06.07.2026, gjate shqyrtimit te dokumentacionit të ofruar nga Autoriteti Kontraktues, ne mënyrë jo transparente DataProgNet SH.P.K. nuk është lejuar të kemi qasje ne pjeset e ofertave që nuk i takojn sekretit bazuar ne LPP, pjesë te ofertave që është bazuar vlerësimi teknik i ofertave bazuar ne dosjen e tenderit si në vijim:

Propozimin Teknik;

Planin Dinamik;

Dokumentacionin e stafit të dedikuar dhe

Dokumentacionin tjetër të ofertës që lidhet me përmbushjen e kerkesave teknike.

Më pas me email të datës 06.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar edhe zyrtavisht kërkesën tonë për qasje në këto dokumente duke u mbështetur në nenet 68 dhe 69 të Ligjit per Prokurimin Publik.

Ju njoftojmë se bazuar ne LPP Neni 11, Informatat Sekrete Afariste tek pikat si ne vijim:

3.Autoriteti kontraktues mund ti klasifikojë informatat e tjera si informate sekrete afariste vetem nëse informatat përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

3.1 që ai ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

3.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikujt e tillë sekret dhe

3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulim i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) në të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 11 të LPP-së, duke mos na dhënë qasje në dokumentacionet e pjesëve se ofertës teknike që kanë qenë pjesë e vlerësimit me pikë dhe pa posedimin e këtyre pjesëve ne nuk po kemi mundësi si OE të krahasojmë ofertën tonë teknike me ofertën e OE-se të propozuar për kontrate dhe të OE-ve tjere pjesëmarrës.

Të nderuar, si është e mundur që, në rezultatin e poentimit sipas nënkritereve të vlerësimit, nga 10 (dhjetë) operatorë ekonomikë të cilët i kemi vlerësuar si të përgjegjshëm, DataProgNet Sh.P.K. të renditet e fundit me pikë, ku sic jeni në dijeni DataProgNet Sh.P.K. është kompania që ka zhvilluar sistemin e automatizimit të sporteleve për Postën e Kosovës sh.a., me mbi 15 vite përvojë të dëshmuar dhe me referenca pozitive të lëshuara nga Posta e Kosovës sh.a., të renditet e fundit për nga pikët në këtë aktivitet të prokurimit, krahasuar me kompani që asnjehere nuk kanë punuar me shërbime postare dhe as me shërbime të pagesave.

Në ofertën tonë teknike kemi dorëzuar në mënyrë të detajuar secilën kërkesë të dosjes së tenderit, duke përfshirë.

metodologjinë e punës;

Planin e implementimit,

strukturën e ekipit të angazhuar;

përvojën relevante në projekte të ngjashme;

qasjen ndaj sigurisë, backup-i, rikuperimit dhe integriteteve me sisteme të tjera; dhe modelin e mbështetjes pas implementimit.

Siq janë kërkuar në dosjen e tenderit.

Megjithatë, në rezultatet e vlerësimit që kemi pranuar, nuk jemi njoftuar fare në pikët e fituara nga oferta jonë për secilin nënkriter, as me pikët e operatorëve të tjerë ekonomikë, konkretisht për:

Metodologjinë e punës të parapara maksimum 20 pikë;

Planin dhe afatin e implementimit të parapara maksimum 10 pikë;

Qasjen ndaj sigurisë, backup-it, rikuperimit dhe integriteteve me sisteme të tjera — të parapara maksimum 20 pikë;

Modelin e mbështetjes pas implementimit — të parapara maks 20 pikë; dhe

Ofertën financiare — të parapara maksimum 30 pikë.

Mungesa e transparencës në paraqitjen e pikëve sipas secilit nënkriter e ben të pamundur verifikimin e drejtësisë së vlerësimit dhe bie ndesh me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe llogaridhënies të percaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Duke pasur parasysh përvojën tonë të dëshmuar, cilësinë e ofertës së dorëzuar dhe mungesën e një arsytimi të detajuar të poentimit, ju kërkohet që ta rishqyrtoni me kujdes këtë proces të vlerësimit dhe ta ktheni projektin në rivlerësim apo anulim nga një komision që garanton vlerësim objektiv duke ofruar një arsyetim të plotë dhe transparent të pikëve të dhëna për secilin nënkriter, në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e Ligjit Për Prokurimin Publik.

Në rast se kjo kërkesë nuk merret parasysh dhe nuk sigurohet një proces i drejtë dhe transparent i rivlerësimit do të jemi të detyruar të ushtrojmë të drejtën tonë ligjore për të paraqitur ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe për të ndjekur të gjitha rrugët juridike të parapara me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret lidhur me secilin dokument individual dhe nuk ka sqaruar se për cilën arsye secili prej tyre konsiderohet sekret afarist,

Vete fakti që Operatori Ekonomik i propozuar si tenderues i suksesshëm i ka klasifikuar dokumentet si konfidenciale nuk e përjashton detyrimin e Autoritetit kontraktues për të vlerësuar nëse klasifikimi është bërë në përputhje me Ligjin Për Prokurimin Publik dhe për të mundësuar qasje në atë pjesë të dokumentacionit që nuk përbëjnë sekret afarist ose në versione të ndryshuara (përditsuara).

Mosdhënia e këtyre dokumenteve e pa mundëson ushtrimin efektiv të së drejtës për rishqyrtim, pasi DataProgNet SH. P. K. nuk ka mundësi të verifikojë nëse Operatori Ekonomik i rekomanduar ka përmbushur kërkesat teknike dhe administrative në Dosjes së Tenderit dhe nëse Komisioni Vlerësues ka zbatuar kriteret e vlerësimit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Sic jeni në dijeni, DataProgNet SH.P.K. është kompania që prej shumë vitesh ka zhvilluar, implementuar dhe mirëmbajtur Sistemin e Automatizimit të Sporteleve të Postës (SASP), i cili përbën sistemin qendror të operimit Postës së Kosovës Sh.A. dhe është pikërisht objekti i këtij aktiviteti të prokurimit.

Për këtë arsye, Propozimi teknik, Plani Dinantik i implementimit dhe dokumentacioni i stafit kyq përbëjnë dokumentacionin të rëndësishëm për të vlerësuar nëse zgjidhja e propozuar nga operatori ekonomik i rekomanduar është realisht e realizueshme dhe në përputhje kompleksitetin teknik, funksional dhe operacional të sistemit ekzistues.

Bazuar në përvojën tonë shumëvjeqare si zhvillues dhe mirëmbajtës i këtij sistemi, jemi të befashuar se si është konsideruar e realizueshme një ofertë që pretendon ndërtimin nga fillimi të një sistemi të ri qendror për Postën e Kosovës sh.a. brenda afateve të implementimit të propozuara. Një plan i tillë, sipas vlerësimit tonë profesional dhe përvojës sonë praktike, nuk është realisht i zbatueshëm. Ku Posta e Kosovës sh.a. e din mirë dhe ka fakte sa kushton një sistem i tillë dhe sa duhet kohë për një OE të ri të i kuptoj këto procese.

Vetëm faza e analizimit të proceseve të biznesit, studimit të legjislacionit, analizës së kërkesave funksionale dhe teknike, si dhe kuptimit të proceseve operative të Postës së Kosovës, ka kërkuar vite pune dhe zhvillim të vazhdueshëm për të u kuptuar nga ne si OE shumë i përkushtuar. Këto procese nuk mund të zëvendësohen apo të realizohen brenda pak javësh ose muajsh pa krijuar rreziqe serioze për funksionimin e sistemit.

Shprehim shqetësimin tonë se në vend që të investohet në avancimin dhe modernizimin e sistemit ekzistues, i cili është ndërtuar dhe përmirësuar ndër vite, është zgjedhur qasja për ndërtimin e një sistemi të ri nga fillimi. Ky vendim sipas vlerësimit tonë profesional, paraqet rrezik të konsiderueshëm për vazhdimësinë e shërbimeve dhe për investimin shumë vjeçar të bërë nga Posta e Kosovës ku vlera e mirëmbajtjes mujore siç e dini është simbolike, por ne si OE vazhdimisht ju kemi kuptuar me sqarimet që na keni dhënë se nuk po qëndroni mirë financiarisht si Postë e Kosovës dhe kemi krijuar nënsisteme të shumta brenda sistemit SASP pa pagesa shtesë dhe kemi dhënë shërbime edhe për këto nënsisteme dhe module me vite e dekada vetëm e vetëm që një ditë Postën Publike të vendit dhe shtetit tonë të shohim të krahasueshme me postat publike ndërkombëtare.

Pas analizimit të dosjes së tenderit kemi konstatuar se pothuajse të gjitha kërkesat funksionale të kërkuara në këtë procedurë tashmë janë të implementuara nga sistemi aktual SASP. Për më tepër sistemi ekzistues përmban 70 % më shumë module, nën-sisteme dhe funksionalitetet sasa ato të kërkuara në dokumentacionin e tenderit. Kjo tregon se nevoja reale nuk është zëvendësimi i sistemit, por zhvillimi dhe avancimi i tij në përputhje me kërkesat e reja të biznesit.

Vlerësuar nga vet Posta e Kosovës sh.a SASP-i aktual është një sistem modern, i krahasueshëm me sistemet e implementuara në administratat postare të vendeve evropiane dhe me gjere dhe perfaqeson nje investim te rendesishem institucional. Per kete arsye konsiderojme se rivleresimi e nese eshte e

nevojshme edhe anulimi i kesaj procedure te prokurimit, eshte ne interes te drjeteperdrejte te postes se kosoves sha dhe te mbrojtejes se interesit publik.

Gjithashtu, nese Posta e Kosoves nuk ka pasur ne plan te vazhdoje perdorimin dhe zhvillimin e sistemit SASP, do te ishte e arsyeshme dhe ne perputhje me parimet e bashkepunimit kontraktual qe fillimisht te njoftoj data Prognnet SHPK pasi Posta eshte duke shfrytezuar sistemin qe eshte ne pronesi te kompanise sonë, duke pasur parasysh se ndermjet palëve ekziston një kontratë valide dhe ne fuqi ,për të cilën Autoriteti Kontraktues është në dijeni.

Në përfundim, bazuar në analizën tonë teknike dhe përvojën shumë vjeçare në këtë projekt, konsiderojmë se humbësi më i madh i kësaj procedure ,nese vazhdon në këtë formë,nuk do të jetë DataProgNet SHPK por vetë Posta e kosoves sha e cila rezikon të humbase një sistem te konsoliduar,të dëshmuar dhe të zhvilluar ndër vite, duke u ekspozuar ndaj rreziqeve te panevojshme teknike, operacionale dhe financiare.

Nga raporti i vlerësimit rrjedh se Operatori ekonomik i rekomanduar është vlerësuar me pikët maksimale për kriteret teknike,ndërsa DataProgNet Shpk është vlerësuar me pikë dukshëm më të ulëta. Për shkak të mungesës se qasjes ne dokumentacionin teknik.DataProgNet shpk nuk ka mundesi te verifikoj nese ky vleresim eshte bere ne perputhje me dosjen e tenderit dhe dispozitat e Ligjit Per Prokurim Publik, duke krijuar dyshime te arsyshme mbi ligjshmerine dhe objektivitetin e procesit te vleresimit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se transparenca e plote e procesit te vleresimit teknik dhe qasja ne arsyetimin e detajuar per secilin kriter jane te domosdoshme per te mundesuar verifikimin e ligjshmerise, barazise ne trajtim dhe zbatimit korrekt te kriterëve te vleresimit.

Përgjigja e AK-së në pretendimet e OE-së ankuese DataProgNet SHPK

Lidhur me dispozitat e lartë cekura të cilat operatori ekonomik pretendon se janë shkelur,

AK Posta e Kosovës sqaron si vijon:

Autoriteti Kontraktues sqaron se qëllimi i nenit 1 të LPP-së është të udhëzoj dhe siguroj menyrë më efikase, më transparente dhe me te drejtë të shfrytëzimit te fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe do te ndiqen, te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet qe do te permbushen. Andaj ky pretendim, nga OE ankues është përmendur vetëm sipërfaqësisht pa paraqitur asnjë fakt dhe pa ofruar asnjë argument se AK Posta e Kosoves e ka shkelur nenin 1 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues sqaron se qëllimi i nenit 7 dhe 59 të LPP-së është që të udhëzoj autoritetet kontraktuese se si ti trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim, në mënyrë transparente si dhe konformë kërkesave dhe dëshmime të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, po ashtu AK konform nenit 59 të LPP-së ka themeluar komisionin e vlerësimit dhe i njëjti ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve duke respektuar dhe trajtuar të gjitha ofertat në mënyrë të barabartë, i njëjti konform kërkesave të parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka bërë vlerësimin e të gjitha ofertave dhe sipas situatave edhe ka kërkuar sqarime dhe gjitha konstatimet e tyre i kanë potencuar në raportin e vlerësimit. Andaj ky pretendim, nga OE ankues është përmendur vetëm sipërfaqësisht pa paraqitur asnjë fakt dhe pa ofruar asnjë argument se AK Posta e Kosovës sh.a, me rastin e vlerësimit të ofertave, e ka shkelur nenin 7 dhe 59 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues sqaron se qëllimi i nenit 10, 11 dhe 68 është se me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit dhe se autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen.

Nëse dokumenti përmban vetëm informacione që autoriteti kontraktues i ka klasifikuar si informacione sekrete afariste sipas paragrafit 3 të nenit 10 të LPP-së, të këtij neni, dhe prandaj ky autoritet kontraktues vendos që këtë dokument ta largoj nga materiali në të cilin palët e interesuara dhe anëtarët e publikut kanë të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kontraktues duhet të përgatis dhe përfshijë në dokumentacionin në të cilin publiku ka qasje, një përmbledhje të përmbajtjes së përgjithshme të dokumentit sekret.

Autoriteti Kontraktues iu ka përmbajtur Dokumenteve për sekret afarist në bazë të Aneksit 3 të D.T Kërkesa për sekret afarist të plotësuar prej të gjithë Operatorëve Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar kërkesat për sekret afarist të dorëzuara nga operatorët ekonomikë dhe ka konstatuar se dokumentet e kërkuara, si propozimi teknik, plani dinamik dhe dokumentacioni i stafit, përmbajnë elemente teknike, organizative, komerciale dhe know-how profesional, zbulimi i të cilave ndaj operatorëve konkurrentë do të cenonte interesat legjitime komerciale të operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, AK nuk mund t'i zbulojë këto pjesë, por mund të ofrojë vetëm të dhëna jo-konfidenciale, pikëzim, formulat e vlerësimit dhe arsyetimin e përgjithshëm të vlerësimit.

AK sqaron se iniciimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bazuar në nevojën institucionale për modernizim të sistemit qendror, ngritje të sigurisë, përmirësim të mirëmbajtshmërisë, përdorim të teknologjive aktuale të kohës dhe të mbështetura, si dhe përshtatje me kërkesat e reja funksionale, operative dhe integruuese të Postës së Kosovës Sh.A. Sistemi ekzistues, pavarësisht shërbimit të tij ndër vite, ka kufizime teknike dhe arkitekturore që lidhen me vjetërsimin e teknologjisë, ciklin e mbështetjes së komponentëve teknologjikë dhe kërkesat bashkëkohore të sigurisë dhe integritetit. Për këtë arsye, AK ka pasur të drejtë dhe nevojë objektive të zhvillojë procedurë konkurruese për sistem të ri/modernizuar qendror.

Arsyeja e OE-se ankuese se AK-Posta e Kosoves sh.a nuk e ka njoftuar fare për pikët e fituara për secilin kriter dhe nenkriter, as me pikët e operatoreve të tjerë ekonomik, konkretisht për:

Metodologjia e punës -20 pikë

Planin dhe afatin e implementimit -10 pikë

Qasja ndaj sigurisë, backup-it dhe integritetit

Mbështetja pas implementimit

Oferta financiare

AK-Posta e Kosoves gjegjësisht njësia e prokurimit sqaron se OE-ankuese në momentin për qasje në dokumentet e këtij aktiviteti të prokurimit është paisur edhe me raportin e vlerësimit të bashku me procesverbalet e secilit OE pjesëmarrës, ku në raport të vlerësimit dhe në procesverbal në formë tabelare janë paraqitur të gjitha kriteret dhe nenkriteret duke filluar nga:

1. Çmimi
2. Metodologjia e punës
3. Planin dhe afatin e implementimit
4. Qasja ndaj sigurisë, backup-it dhe integritetit
5. Mbështetja pas implementimit

Po ashtu OE-ankuese është paisur edhe me përshkrimin e çmimit (ofertat financiare të të gjithë OE-ve pjesëmarrës)

Vlenë të theksohet se: Çmimi, Afati i implementimit dhe Kohëzgjatja e mbështetjes pas implementimit, janë vlerësuar/llogaritur sipas formulave matematikore që janë të paraqitura në Aneksin 6 të D.T, ndërsa kriteret dhe nenkriteret tjera janë vlerësuar nga secili anëtar i komisionit dhe rezultati

përfundimtar është kalkuluar sipas formulës/mesatares se aplikuar (të gjitha këto OE-ankuese i ka ne dispozicion përkatësisht ne raportin e vlerësimit dhe procesverbalin nga komisioni i vlerësimit)

Sqarim: OE-ankuese me dt.06.07.2026 pasi ka pranuar përmes USB dokumentacionin e kërkuar me dt. 03.07.2026 ka dërguar e-mail ku ka kërkuar dokumentacionin shtesë te OE-se se propozuar për dhënie te kontratës:

- 1.Plani dinamik nga Cactus SH.A
- 2.Porpozimi teknik nga Cactus SH.A
- 3.Stafi i dedikuar për projekt nga Cactus SH.A

Njësia e prokurimit përmes e-mailit dt. 06.07.2026 ka kthyer përgjigje:

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues nuk mund të ofrojë qasje në dokumentet e kërkuara te Operatorit Ekonomik te propozuar për dhënie të kontratës "Cactus shpk":

- 1.Plani dinamik
- 2.Propozimi teknik dhe
- 3.Stafi i dedikuar

Ky qëndrim mbështetet në dispozitat e LPP-së që rregullojnë transparencën, qasjen në dokumentacion dhe mbrojtjen e informatave sekrete afariste, përkatësisht në detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të siguruar qasje të arsyeshme në dokumentacionin jo-konfidencial dhe njëkohësisht për të mbrojtur informatat e klasifikuara dhe të verifikuara si sekret afarist.

Vlen të theksojmë se edhe OE ankuese DataProgNet shpk ka aplikuar-kërkuar nga AK përmes Aneksit 3 te D.T që të njëjtat dokumente sikurse OE-se se propozuar për dhënie te kontratës të klasifikohen si sekret afarist.

AK- njësia e prokurimit ka aplikuar standard të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë. Dokumentet teknike të operatorit të rekomanduar nuk janë zbuluar për DataProgNet SH.P.K. për të njëjtën arsye për të cilën dokumentet teknike të DataProgNet SH.P.K. nuk do t'u zbuloheshin operatorëve tjerë ekonomikë. Kjo përbën trajtim të barabartë dhe mbrojtje të informatave konfidenciale të secilit operator ekonomik, pa diskriminim.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar kërkesat për sekret afarist të dorëzuara nga operatorët ekonomikë dhe ka konstatuar se dokumentet e kërkuara, si propozimi teknik, plani dinamik dhe dokumentacioni i stafit, përmbajnë elemente teknike, organizative, komerciale dhe know-how profesional, zbulimi i të cilave ndaj operatorëve konkurrentë do të cenonte interesat legjitime komerciale të operatorëve

ekonomikë. Për këtë arsye, AK nuk mund t'i zbulojë këto pjesë, por mund të ofrojë vetëm të dhëna jo-konfidenciale, pikëzim, formulat e vlerësimit dhe arsyetimin e përgjithshëm të vlerësimit.

AK sqaron se vlerësimi i ofertës së OE-se ankuese DataProgNet SH.P.K. është bërë në secilin kriter dhe nënkriter sipas Aneksit 6 dhe TOR-it.

Afati dhe plani i implementimit të ofertës së DataProgNet SH.P.K., AK- njësia e prokurimit sqaron se këto janë vlerësuar si dy elemente të ndara sipas Aneksit 6. Afati i implementimit është vlerësuar me formulë dhe DataProgNet SH.P.K. ka marrë 1.50/4 pikë, bazuar në afatin e deklaruar në ofertë dhe formulën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Ndërsa plani i implementimit është vlerësuar me 4/6 pikë, pasi Komisioni ka konstatuar se plani përfshin fazat kryesore si analiza, projektimi, zhvillimi, integrimet, testimi, trajnimi dhe vendosja në prodhim, por nuk është mjaftueshëm i detajuar në aspekt të aktiviteteve të ndara, output-eve, aprovimeve, varësive, përgjegjësi, mekanizmat e kontrollit dhe pranimit të rezultateve. Për këtë arsye, plani është konsideruar i pranueshëm dhe i zbatueshëm, por jo në nivel maksimal të detajimit të kërkuar për pikët maksimale.

Siguria e sistemit, oferta e OE-së DataProgNet shpk është vlerësuar me 7/8 pikë, pasi përmban elemente të mira të autentikimit, autorizimit, RBAC, audit trail, enkriptimit dhe monitorimit.

Backup dhe rikuperimi, oferta e OE-së DataProgNet shpk është vlerësuar me 4/6 pikë, pasi qasja e paraqitur nuk është konsideruar mjaftueshëm e matshme në aspekt të frekuencës, lokacionit, versionimit, retention-it, testimit periodik të rikuperimit dhe parametrave RPO/RTO.

Integrimet me sisteme tjera, oferta e OE-së DataProgNet shpk është vlerësuar me 5/6 pikë, pasi paraqet qasje të pranueshme përmes API dhe web services, por modeli i komunikimit, fleksibiliteti për integritime të ardhshme dhe mekanizmat praktikë të ndërveprimit nuk janë elaboruar në nivel maksimal.

Koha e reagimit ndaj incidenteve, oferta e OE-së DataProgNet shpk është vlerësuar me 4/8 pikë, bazuar në kohët e deklaruar dhe në vlerësimin e Komisionit mbi nivelin e reagimit, eskalimit dhe mbulueshmërisë operative.

Mënyra dhe organizimin e mbështetjes, oferta është vlerësuar me 3/3 pikë, pasi në këtë pjesë Komisioni ka konstatuar se organizimi i mbështetjes është i pranueshëm sipas kërkesave të nënkriterit.

OE ankuese DataProgNet pretendon se ndërtimi i një sistemi të ri qendror nga fillimi, brenda afateve të propozuara, nuk është realisht i zbatueshëm dhe se një OE i ri nuk mund t'i kuptojë proceset e Postës brenda pak javësh/muajsh.

AK- njësia e prokurimit sqaron se pretendimi i OE ankues lidhur me pamundësinë e implementimit të sistemit të ri brenda afateve të propozuara nuk mund të pranohet si bazë për anulim apo rivlerësim vetëm mbi vlerësimin subjektiv të OE-së ankues. Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar afatin dhe planin e implementimit të secilit operator ekonomik sipas kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit - Aneksin6.

Fakti që OE ankuese DataProgNet SH.P.K. ka përvojë shumëvjeçare me sistemin ekzistues SASP nuk e bën automatikisht të paralizueshëm planin e një operatori tjetër dhe nuk krijon bazë për përjashtimin e ofertave tjera. Komisioni ka pasur për detyrë të vlerësojë dokumentacionin e dorëzuar nga secili OE dhe jo të supozojë pamundësi implementimi vetëm për shkak se operatori tjetër nuk ka qenë zhvillues i sistemit ekzistues.

Në shqyrtim u vërtetua se Autoritetit Kontraktues respektivisht komisioni vlerësues me të drejtë konform LPP-së dhe rregullave dytesore për prokurim publik ka shpallur fitues OE-në e përgjegjshëm me çmim "ekonomikisht më të favorshëm" lidhur me aktivitetin e prokurimit, pasi i ka analizuar dhe vlerësuar me kujdes të shtuar të gjitha ofertat e pranuar duke respektuar me përpikëri kërkesat dhe kriteret e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e paknaqur mund të ushtrojë ankesë brenda 10 dite pranë OSHP-së konform paragrafit 2 te nenit 109 te LPP-së.

T'i dërgohet:

1x OE "DataProgNet Shpk", Prishtinë

1x Zyrës së Kryeshefit

1x Arkivit

1x Lëndës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY



UNIREF

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT



Të dhënat e OE
Podaci EO
EO data

"DataProgNet" SH.P.K., Rr. Qamil Ilazi, Nr.16, 70000 Ferizaj

Përshkrimi
Opis
Description

Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a

Numri i prokurimit
Broj nabavke
Procurement number

vetak-26-1925-2-1-1

Shuma / Iznos
Amount

€ 1416 Euro 00 Ct Data / Datum / Date

Me fjalë / Rečima
In words

Xhirollogaria
Broj žiroračuna
Bank account

1000430070005756

Lëshuar nga
Izdato od /
Issued by

OSHP



Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 të LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

b. Kurdo që aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN.

a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €.

b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.

761101613 18.07.2026 18:12:47

Pagesë e faturave / Bill Payments

Nr. i llogarisë / Account No: XK051170179541000154
Emri i llogarisë / Account name: DATAPROGNET SHPK
Emri tregtar / Commercial name: DATAPROGNET SHPK
Kodi Utilitar / Utility Code: 26 Komisioni Rregullativ i Prok.Publik -1000430070005756
Referenca e pagesës / Payment reference: PPQDD1111111111H Ankesë
për lëndën me Nr. të
prokurimit vetak-26-1925-2-1-
1 me titull "Zhvillimi dhe
implementimi i sistemit
qendror të Postës së Kosovës
sh.a."
Shuma / Amount: 1,416.00 EUR
Provizioni / Commission: 0.80
Shuma totale / Total amount: 1,416.80
Data / Date: 18.07.2026
Pershkrimi i pagesës / Payment description: Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)

CONFIRMED

Date: 18.07.2026



ProCredit Bank